



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
I SANKSIONEVE

Data: 19 Prill 2021

Nr: 21

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 12, PARAQITUR NË  
KQZ NË DATËN 15.04.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 19.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet

**OBJEKT:** Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 12, të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 224, datë 14.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e raportit të Autoriteti të Medias Audiovizive të pasqyrimin të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26.3.2021 – 3.4.2021”.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

### **VËREN:**

Ankuesi PDIU ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 12 regj., datë 15.04.2021.

Në mbledhjen e datës 19.04.2021, ora 11:00, pas relativitetit të z. Elvin Lako dhe diskutimit të përfaqësuesit të subjektit ankues, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 12 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17 pika 3, shkronja “a” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, Kërkesa Ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17 pika 3, shkronjat “a” e 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”,

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 12, datë 15.04.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 20 Prill, në orën 16:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Elvin LAKO** - **Relator**

**Elvis ÇEFA** - **Anëtar**

**Koli BELE** - **Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI** - **Anëtar**

**Ledio BRAHO** - **Anëtar**

